(6) За случаите од ставовите (4) и (5) на овој член контролорот обезбедува информациска трага (на пример: записник), која ги содржи сите податоци за целосна идентификација на медиумот, како и за категориите на лични податоци кои биле снимени на истиот.	(6) Për çështjet nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, kontrolluesi duhet të sigurojë gjurmë informacioni (për shembull: procesverbal), i cili përmban të gjitha të dhënat për identifikimin e plotë të mediumit, si dhe për kategoritë e të dhënave personale të regjistruara në të njëjtin.
Криптирање на личните податоци	**Kriptimi i të dhënave personale**
Член 25	**Neni 25**
(1) Кога контролорот врз основа на анализата на ризикот, а земајќи ги предвид природата, обемот, контекстот и целите на обработката на личните податоци, врши криптирање на личните податоци, секогаш применува најсовремени технички решенија за криптирање со кои го обезбедува интегритетот, доверливоста и автентичноста на личните податоци.	(1) Kur kontrolluesi bazuar në analizën e rrezikut, dhe duke marrë parasysh natyrën, përmasën, kontekstin dhe objektivat e përpunimit të të dhënave personale, bën kriptimin e të dhënave personale, gjithmonë zbaton zgjidhjet më moderne të kriptimit teknik me të cilat siguron integritetin, besueshmërinë dhe autenticitetin e të dhënave personale.
(2) Во согласност со ставот (1) на овој член контролорот применува единствено признати и безбедни алгоритми за криптирање (како на пример: SHA-256, SHA-512 или SHA-341 како хаш функција, HMAC	(2) Sipas paragrafit (1) të këtij neni, kontrolluesi zbaton vetëm algoritmet e pranuara dhe të sigurta të kriptimit (siç janë: SHA-256, SHA-512 ose SHA-341 si funksion hash, HMAC duke përdorur SHA-256, bcrypt, scrypt ose PBKDF2

користејќи SHA-256, bcrypt, scrypt или PBKDF2 за чување лозинки, AES или AES-CBC за симетрично криптирање, RSA-OAEP v2.1 за асиметрично криптирање...), а воедно обезбедува заштита на тајните клучеви за криптирање со ограничувачки права за пристап и посебно креирана безбедна лозинка за пристап.	për ruajtjen e fjalëkalimeve, AES ose AES-CBC për kriptim simetrik, RSA-OAEP v2.1 për kriptim asimetrik ...) kurse gjithashtu siguron mbrojtje të çelësave sekret të kriptimit me të drejta kufizuese të hyrjes dhe fjalëkalim të sigurt të krijuar posaçërisht për qasje.
(3) Контролорот донесува внатрешна процедура во која задолжително се пропишува начинот на управување со тајните клучеви и сертификати, земајќи го предвид и управувањето со ризикот на заборавени лозинки.	(3) Kontrolluesi do të miratojë procedurë të brendshme, ku detyrimisht rregullon menaxhimin e çelësave sekretë dhe certifikatave, duke marrë parasysh menaxhimin me rrezikun e fjalëkalimeve të harruara.
Физичка безбедност	**Siguria fizike**
Член 26	**Neni 26**
(1) Контролорот задолжително применува зајакнато ниво на безбедност во однос на просториите во кои се сместени и се чуваат серверите и мрежната опрема преку кои се врши обработка на личните податоци со примена на соодветни мерки кои обезбедуваат дека само лица посебно овластени од контролорот имаат пристап, како и мерки со кои се намалува ризикот од потенцијални закани и тоа:	(1) Kontrolluesi doemos duhet të zbatojë nivel të përforcuar të sigurisë në lidhje me hapësirat ku janë vendosur dhe ku ruhen serverët dhe pajisjet e rrjetit, nëpërmjet të cilave kryhet përpunimi i të dhënave personale duke zbatuar masat e duhura të cilat sigurojnë që vetëm personat e autorizuar posaçërisht nga kontrolluesi të kenë qasje, si dhe masa me të cilat zvogëlohet rreziku i kërcënimeve të mundshme, edhe atë:
инсталирање на алармни системи против упад и нивна периодична проверка;	- instalimin e sistemeve të alarmit kundër ndërhyrjeve dhe kontrollit periodik të tyre;
примена на мерки и контроли за превенција од кражба, пожар, експлозии, чад, вода, прашина, вибрации, хемиски влијанија, пречки во снабдувањето со електрична енергија и електромагнетно зрачење;	- zbatimi i masave dhe kontrolleve për parandalimin e vjedhjeve, zjarreve, shpërthimeve, tymit, ujit, pluhurit, dridhjeve, ndikimeve kimike, pengesa në furnizimin me energji elektrike dhe rrezatimi elektromagnetik;

обезбедување безбедност на клучевите и шифрите за аларми кои овозможуваат пристап до просториите;	- sigurim të çelësave dhe kodeve të alarmit që mundësojnë hyrje në hapësira;
- обезбедување на одделни области во објектот каде се чуваат серверите според анализата на ризик (на пример: употреба на посебна контрола за пристап за сервер салата);	- sigurim të fushave të ndara në objektin ku ruhen serverët sipas analizës së rrezikut (për shembull: përdorim të një kontrolli të veçantë për qasje në dhomën e serverëve);
- ажуриран список на лица или категории на лица кои се овластени да влезат во просториите каде се чува опрема на која се врши обработка на личните податоци;	- listë e përditësuar e personave ose kategorive të personave të autorizuar për të hyrë në hapësirat ku ruhen pajisjet për përpunimin e të dhënave personale;
- воспоставување на правила и методи за контрола на пристапот на посетителите и тоа минимум со придружба од едно лице во контролорот со посетителите надвор од областите за прием на странки;	- vendosjen e rregullave dhe metodave për kontrollimin e qasjes së vizitorëve, edhe atë të paktën të jenë të shoqëruar nga një person në kontrollues me vizitorët jashtë fushave për pranimin e palëve;
- посебна физичка заштита на ИТ-опремата преку специфични методи (систем за спречување на пожар, поплави, електрична енергија, климатизација, итн.);	- mbrojtje e veçantë fizike e pajisjeve së IT-së nëpërmjet metodave specifike (sistemi i parandalimit të zjarrit, përmbytjet, energjia elektrike, klimatizim etj.);
- одржување на просториите за серверите (климатизација, UPS, итн.).	- mirëmbajtja e dhomës së serverëve (klimatizim, UPS etj).
- водење на евиденција за пристап до просториите каде што се чуваат серверите кои содржат лични податоци;	- mbajtja e shënimeve për qasje në hapësirat ku ruhen serverët që përmbajnë të dhëna personale;
- обезбедување дека само овластените лица можат да пристапат до просториите со ограничен пристап (на пример: во внатрешноста на контролираните простории за пристап, сите лица да носат видлива	- duke siguruar që vetëm personat e autorizuar mund të hyjnë në hapësirat me qasje të kufizuar (për shembull: brenda hapësirave të kontrolluara për qasje, të gjithë personat të mbajnë identifikim të dukshëm (kartelë), si dhe rishqyrtim dhe përditësim të rregullt të lejeve

идентификација (картичка), како и преиспитување и редовно ажурирајте на дозволите за пристап до заштитените области).	të hyrjes në zonat e mbrojtura).
- (2) По исклучок од ставот (1) на овој член, серверите на кои се инсталирани софтверски програми за обработка на личните податоци, можат да бидат физички лоцирани, хостирани и администрирани надвор од просториите на контролорот.	(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, serverët në të cilët janë instaluar programe softuerike për përpunimin e të dhënave personale, mund të lokalizohen, hostohen dhe të administrohen jashtë hapësirave të kontrolluesit.
- (3) Во случајот од ставот (2) на овој член, меѓусебните права и обврски на контролорот и правното, односно физичкото лице кај кое се физички лоцирани, хостирани и администрирани серверите, треба да бидат уредени со договор во писмена форма, кој задолжително ќе содржи мерки за безбедност на личните податоци согласно прописите за заштита на личните податоци.	(3) Në rastin e paragrafit (2) të këtij neni, të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të kontrolluesit dhe personit juridik, përkatësisht personit fizik, ku serverët janë të lokalizuar, të hostuar dhe të administruar fizikisht, duhet të rregullohen me marrëveshje me shkrim, e cila detyrimisht do të përmbajë masa për sigurinë e të dhënave personale, në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.
Контрола на информацискиот систем и информатичката инфраструктура	**Kontrolli i sistemit të informacionit dhe infrastrukturës së informacionit**
Член 27	**Neni 27**
(1) Во документацијата за технички и организациски мерки утврдена во членот 10 од овој правилник, задолжително треба да се содржани постапките за овластување на офицерот за заштита на личните податоци, за вршење периодични контроли, заради следење на усогласеноста на работењето на контролорот со прописите за заштита на	(1) Në dokumentacionin për masat teknike dhe organizative të përcaktuara në nenin 10 të kësaj Rregullore, detyrimisht duhet të figurojnë procedurat e autorizimit të zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale, për kryerjen e kontrolleve periodike, me qëllim të mbikëqyrjes të përshtatshmërisë së punës së kontrolluesit me dispozitat për mbrojtjen e të

личните податоци и со донесената документација за технички и организациски мерки.	dhënave personale dhe me dokumentacionin e miratuar për masat teknike dhe organizative.
(2) Информацискиот систем и информатичката инфраструктура на контролорот задолжително подлежат на годишна внатрешна контрола со цел да се провери дали постапките и упатствата содржани во правилата и политиките за безбедност на личните податоци се применуваат и се во согласност со прописите за заштита на личните податоци.	(2) Sistemi i informacionit të kontrollorit dhe infrastruktura e informacionit duhet t'i nënshtrohen kontrollit të brendshëm vjetor për të kontrolluar nëse procedurat dhe udhëzimet e përfshira në rregullat dhe politikat për sigurinë e të dhënave personale janë zbatuar dhe janë në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
Управување со обработувачи	**Menaxhimi me përpunuesit**
Член 28	**Neni 28**
(1) Контролорот е должен да воспостави процес на управување при користење на услуги за обработка на личните податоци од страна на обработувачи, а со цел да се воспостават соодветни процедури за одлучување при изборот на обработувачот, управување со обработката на личните податоци, како и исполнување на договорените обврски и одговорности од страна на обработувачот.	(1) Kontrolluesi është i obliguar të krijojë proces të menaxhimit kur përdor shërbime të përpunimit të të dhënave personale nga përpunuesit, me qëllim të vendosjes së procedurave të përshtatshme të vendimmarrjes në përzgjedhjen e përpunuesit, menaxhimin e përpunimit të të dhënave personale, si dhe përmbushjen e obligimeve të kontraktuara dhe përgjegjësive nga përpunuesi.
(2) Контролорот е должен да применува процедура за одлучување за избор на обработувач со која задолжително ќе предвиди:	(2) Kontrolluesi është i obliguar të zbatojë procedurë vendimmarrjeje për zgjedhjen e përpunuesit, me të cilin do të parashikojë detyrimisht:
1. Анализа на потенцијалните обработувачи во однос на нивните технички и организациски мерки за обезбедување на гаранција дека обработката на личните податоци ќе се одвива во согласност со барањата предвидени во прописите за заштита на личните податоци, како и за обезбедување на заштита на правата на субјектите на лични податоци; и	1. Analiza e përpunuesve të mundshëm në lidhje me masat e tyre teknike dhe organizative për të siguruar që përpunimi i të dhënave personale do të bëhet në përputhje me kërkesat e parapara në dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale; dhe

2. Анализа на ризиците врз работењето на контролорот што можат да произлезат при обработката на личните податоци од страна на обработувачите.	2. Analiza e rrezikut për funksionimin e kontrolluesit që mund të paraqiten gjatë përpunimit të të dhënave personale nga përpunuesit.
Ангажирање на обработувачи	**Angazhimi i përpunuesve**
Член 29	**Neni 29**
(1) Во случај кога контролорот ќе одлучи да пренесе работи од неговиот делокруг на работа поврзани со обработка на лични податоци на обработувачот, должен е да обезбеди дека личните податоци се обработуваат под негов надзор над безбедноста на личните податоци, при што личните податоци мора да бидат обработувани со безбедносни гаранции.	(1) Në rast se kontrolluesi vendos të transferojë gjëra nga sfera e tij e punës në lidhje me përpunimin e të dhënave personale të përpunuesit, ai është i obliguar të sigurojë që të dhënat personale përpunohen nën mbikëqyrjen e tij për sigurinë e të dhënave personale, ku të dhënat personale duhet të përpunohen me garanci të sigurisë.
(2) Во случаите од ставот (1) на овој член, контролорот може да пренесе работи само на обработувач кој може да обезбеди доволно гаранции, особено во однос на потребното знаење од областа на заштитата на личните податоци, сигурноста и ресурсите.	(2) Në rastet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, kontrollori mund të transferojë punime vetëm tek një procesor i cili mund të sigurojë garanci të mjaftueshme, veçanërisht në lidhje me njohuritë e nevojshme në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, sigurisë dhe burimeve.
(3) Меѓусебните права и обврски на контролорот и обработувачот мора да бидат уредени со договор при што контролорот пред да го склучи договорот е должен да побара од обработувачот (давател на услугата), да му ја презентира својата безбедносна политика во однос информацискиот систем и информатичкта инфраструктура на која ќе се врши обработката на личните податоци во име на контролорот.	(3) Të drejtat dhe obligimet e ndërsjella të kontrolluesit dhe përpunuesit duhet të rregullohen me marrëveshje, ku kontrolluesi para lidhjes së kontratës obligohet të kërkojë nga përpunuesi (ofruesi i shërbimit) që të paraqesë politikën e tij të sigurisë në lidhje me sistemin e informacionit dhe infrastrukturën e informacionit në të cilën do të kryhet përpunimi i të dhënave personale në emër të kontrolluesit.
(4) Безбедносната политика од ставот (3) на овој член треба да содржи податоци со кои ќе се гарантита безбедноста на личните податоци, и тоа:	(4) Politika e sigurisë nga paragrafi (3) i këtij neni përmban të dhëna që garantojnë sigurinë e të dhënave personale, edhe atë:

дали и како се врши криптирање на податоците според нивната чувствителност;	- nëse dhe si bëhet kriptimi i të dhënave sipas ndjeshmërisë së tyre;
постоење на процедури кои гарантираат дека никој нема да има неовластен пристап до податоците;	- ekzistimi i procedurave që garantojnë se askush nuk do të ketë qasje të paautorizuar në të dhënat;
дали и како се врши криптирање на преносот на податоци;	- nëse dhe si bëhet kriptimi i të dhënave;
- гаранции во однос на следливост (логови, информациска ревизорска трага...);	- garanci për sa i përket vazhdueshmërisë (regjistra, gjurma e revidimit të informacionit...);
- управување со правата на пристап;	- menaxhimi i të drejtave të qasjes;
- автентикација; и	- autentifikimi; dhe
- други мерки за безбедност на обработката на личните податоци.	- masa të tjera për sigurinë e përpunimit të të dhënave personale.
- (5) Договорот од ставот (3) на овој член треба да содржи одредби особено за:	(5) Marrëveshja nga paragrafi (3) i këtij neni duhet të përmbajë dispozita sidomos për:
- предметот, должината и целта на обработката на личните податоци;	- lëndën, gjatësinë dhe qëllimin e përpunimit të të dhënave personale;
- обврските за обработувачот да преземе технички и организациски мерки за да обезбеди безбедност на обработката на личните податоци;	- obligimet që përpunuesi të marrë masa teknike dhe organizative për të siguruar sigurinë e përpunimit të të dhënave personale;
обврските во однос на доверливоста на доверените лични податоци;	- obligimet në lidhje me besueshmërinë e të dhënave personale të besuara;
- минималните стандарди за автентикација на овластените лица;	- standardet minimale për vërtetimin e personave të autorizuar;
- условите за враќање на податоците и/или нивно уништување по истекот или раскинувањето на договорот;	- kushtet për kthimin e të dhënave dhe/ose shkatërrimin e tyre pas skadimit ose zgjidhjes së kontratës;
- правилата за управување и известување на контролорот во случај на инциденти, односно во случај на нарушување на безбедноста на личните податоци;	- rregullat për menaxhimin dhe njoftimin e kontrolluesit në rast të incidenteve përkatësisht në rast të shkeljes së sigurisë së të dhënave personale;
- обврските за обработувачот да постапува единствено во согласност	- obligimet që përpunuesi të veprojë vetëm në përputhje me udhëzimet e marra nga

со упатствата добиени од страна на контролорот; и	kontrolluesi; dhe
- - другите обврски и одговорности согласно со прописите за заштита на личните податоци и со донесената документација за технички и организациски мерки.	- obligimet dhe përgjegjësitë e tjera në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me dokumentacionin e miratuar për masat teknike dhe organizative.
2. Организациски мерки	**2. Masat organizative**
Организациски мерки за безбедност на личните податоци (минимален стандард)	**Masat organizative për sigurinë e të dhënave personale (standardi minimal)**
Член 30	**Neni 30**
(1) Контролорот е должен да обезбеди соодветни организациски мерки за безбедност на личните податоци врз основа на резултатите од анализата на спроведениот ризик, а особено да обезбеди:	(1) Kontrolluesi është i obliguar të sigurojë masa të përshtatshme organizative për sigurinë e të dhënave personale bazuar në rezultatet e analizës së rrezikut të realizuar, e sidomos të sigurojë:
Ограничен пристап со идентификација за пристап до личните податоци;	Qasje të kufizuar duke identifikuar hyrjen në të dhënat personale;
Организациски правила за пристап на овластените лица до интернет кои се однесуваат на симнување и снимање на документи преземени од електронската пошта и други извори;	Rregulla organizative për qasjen e personave të autorizuar në internet që kanë të bëjnë me shkarkimin dhe incizimin e dokumenteve të marra nga posta elektronike dhe burime tjera;
Уништување на документи по истекот на рокот за нивно чување;	Shkatërrim të dokumenteve pas skadimit të periudhës për ruajtjen e tyre;
1. Мерки за физичка сигурност на работните простории и на информатичко комуникациската опрема каде што се собираат, обработуваат и чуваат личните податоци; и	1. Masa për sigurinë fizike të hapësirave të punës dhe pajisjeve të informacionit dhe komunikimit, ku mblidhen, përpunohen dhe ruhen të dhënat personale; dhe
2. Почитување на техничките упатства при инсталирање и користење на информатичко комуникациската опрема на која се обработуваат личните податоци.	2. Respektim të udhëzimeve teknike gjatë instalimit dhe përdorimit të pajisjes së informacionit dhe komunikimit në të cilat përpunohen të dhënat personale.

3. Вработеното лице кое ги врши работите за човечки ресурси кај контролорот, го известува администраторот на информацискиот систем за вработувањето или ангажирањето на секое овластено лице со право на пристап до информацискиот систем, за да му биде доделено корисничко име и лозинка, како и за престанок на вработувањето или ангажирањето за да му бидат избришани корисничкото име и лозинката, односно заклучени за натамошен пристап.	3. Personi i punësuar i cili kryen punën për burimet njerëzore te kontrolluesi, e informon administratorin e sistemit të informacionit për punësimin ose angazhimin e çdo personi të autorizuar me të drejtën e qasjes në sistemin e informacionit, në mënyrë që të caktohet një emër përdoruesi dhe fjalëkalimi, si dhe përfundimin e punësimit ose angazhimin që t'i fshihet emri i përdoruesit dhe fjalëkalimi përkatësisht të mbyllura për qasje të mëtejshme.
4. Известувањето од ставот (2) на овој член се врши и при било кои други промени во работниот статус или статусот на ангажирањето на овластеното лице што има влијание врз нивото на дозволениот пристап до информацискиот систем.	4. Njoftimi nga paragrafi (2) i këtij neni bëhet gjatë çfarëdo ndryshimi tjetër në statusin e punës ose statusin e angazhimit të personit të autorizuar që ka ndikim në nivelin e qasjes së lejuar deri në sistemin e informacionit.
Информирање и едуцирање за заштитата на личните податоци	**Informimi dhe edukimi për mbrojtjen e të dhënave personale**
Член 31	**Neni 31**
(1) Лицата кои се вработуваат или се ангажираат кај контролорот, пред нивното отпочнување со работа се запознаваат со прописите за заштита на личните податоци, како и со донесената документација за технички и организациски мерки.	(1) Personat që janë të punësuar ose janë të angazhuar me kontrolluesin, para fillimit të punës, njihen me rregulloren për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe me dokumentacionin e miratuar për masat teknike dhe organizative.

(2) За лицата кои се ангажираат за извршување на работа кај контролорот во договорот за нивното ангажирање се наведуваат обврските и одговорностите за заштита на личните податоци.	(2) Për personat që janë të angazhuar për kryerjen e punës së kontrolluesit në kontratën për angazhimin e tyre, përcaktohen obligimet dhe përgjegjësitë për mbrojtjen e të dhënave personale.
(3) Контролорот пред непосредното започнување со работа на овластените лица, дополнително ги информира за непосредните обврски и одговорности за заштита на личните податоци.	(3) Kontrolluesi, para fillimit të drejtpërdrejtë të punës së personave të autorizuar, gjithashtu i informon ata rreth detyrave të drejtpërdrejta dhe përgjegjësive për mbrojtjen e të dhënave personale.
(4) Лицата кои се вработуваат или се ангажираат кај контролорот, пред нивното отпочнување со работа своерачно потпишуваат изјава за тајност и заштита на обработката на личните податоци.	(4) Personat që punësohen ose angazhohen te kontrolluesi, përpara se të fillojnë punën e tyre, nënshkruajnë deklaratë për fshehtësi dhe mbrojtje të përpunimit të të dhënave personale.
(5) Изјавата од ставот (4) на овој член особено содржи: дека лицата ќе ги почитуваат начелата за заштита на личните податоци пред нивниот пристап до личните податоци; ќе вршат обработка на личните податоци согласно упатствата добиени од контролорот, освен ако со закон поинаку не е уредено и ќе ги чуваат како доверливи личните податоци, како и мерките за нивна заштита.	(5) Deklarata nga paragrafi (4) i këtij neni posaçërisht përmban: se personat do t'i respektojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale para qasjes në të dhënat personale; do t'i përpunojnë të dhënat personale në përputhje me udhëzimet e marra nga kontrolluesi, po qe se nuk është e parashikuar me ligj dhe do t'i ruajnë të dhënat personale si të besueshme, si dhe masat për mbrojtjen e tyre.
(6) Изјавата од ставот (4) на овој член задолжително се чува во досиејата на лицата кои се вработуваат или се ангажираат кај контролорот.	(6) Deklarata nga paragrafi (4) i këtij neni duhet të mbahet në dosjet e personave që janë të punësuar ose të angazhuar te kontrolluesi.
(7) Контролорот задолжително врши континуирано информирање и едуцирање на раководството и овластените лица за непосредните обврски и одговорности за заштита на личните податоци.	(7) Kontrolluesi doemos kryen informim dhe edukim të vazhdueshëm të kryesisë dhe personave të autorizuar për obligimet dhe përgjegjësitë e drejtpërdrejta për mbrojtjen e të dhënave personale.
Пристап до документите	**Qasja në dokumente**
Член 32	**Neni 32**
(1) Пристапот до документите треба биде ограничен само за овластени лица на контролорот.	(1) Qasja në dokumente duhet të kufizohet vetëm për personat e autorizuar të kontrolluesit.

(2) За пристапувањето до документите задолжително треба да се воспостават механизми за идентификација на овластените лица и за категориите на личните податоци до кои се пристапува.	(2) Për qasje në dokumente, doemos duhet të krijohen mekanizmat për identifikimin e personave të autorizuar dhe për kategoritë e të dhënave personale në të cilat ka qasje.
(3) Доколку е потребен пристап на друго лице до документите тогаш треба да бидат воспоставени соодветни процедури за таа цел во документацијата за техничките и организациските мерки.	(3) Nëse një person tjetër ka nevojë për qasje në dokumente, atëherë duhet të përcaktohen procedura të duhura për këtë qëllim në dokumentacionin për masat teknike dhe organizative.
Правило „чисто биро”	**Rregulli “zyra e pastër”**
Член 33	**Neni 33**
Контролорот задолжително го применува правилото „чисто биро” при обработката на личните податоци содржани во документите за нивна заштита за време на целиот процес на обработка од пристап на неовластени лица.	Kontrolluesi duhet të zbatojë rregullin “zyra e pastër” gjatë përpunimit të të dhënave personale të përfshira në dokumente për mbrojtjen e tyre gjatë gjithë procesit të përpunimit nga qasja e personave të paautorizuar.
Чување на документи	**Ruajtja e dokumenteve**
Член 34	**Neni 34**
(1) Чувањето на документите треба да се врши на начин со што ќе се применат соодветни механизми за попречување на секое неовластено отворање.	(1) Ruajtja e dokumenteve duhet të bëhet në atë mënyrë ku do të zbatohen mekanizma përkatës për pengimin e çdo hapjeje të paautorizuar.
(2) Кога физичките карактеристики на документите не дозволуваат примена на мерките од ставот (1) на овој член, контролорот треба да примени други мерки кои што ќе го спречат секој неовластен пристап до документите.	(2) Kur karakteristikat fizike të dokumenteve nuk lejojnë zbatimin e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, kontrolluesi duhet të zbatojë masa të tjera që parandalojnë çdo qasje të paautorizuar në dokumente.
(3) Ако документите не се чуваат заштитени на начин определен во ставовите (1) и (2) на овој член, тогаш контролорот треба да ги примени сите мерки за нивна заштита за време на целиот процес на обработка од пристап на неовластени лица.	(3) Nëse dokumentet nuk mbahen të ruajtura në mënyrë të përcaktuar në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, atëherë kontrolluesi duhet t’i zbatojë të gjitha masat për mbrojtjen e tyre gjatë gjithë procesit të përpunimit nga qasja e personave të paautorizuar.

Уништување на документи	**Shkatërrimi i dokumenteve**
Член 35	**Neni 35**
(1) Уништувањето на документите се врши со ситнење или со друг начин, при што истите повторно да не можат да бидат употребливи.	(1) Asgjësimi i dokumenteve bëhet me grimcim ose mënyrë tjetër, pas çka të njëjtat nuk mund të përdoren përsëri.
(2) Во случајот од ставот (1) на овој член комисиски се составува записник кој ги содржи сите податоци за целосна идентификација на документот како и за категориите на личните податоци содржани во истиот.	(2) Në rastin e paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni përpilon procesverbal, i cili përmban të gjitha të dhënat për identifikimin e plotë të dokumentit, si dhe për kategoritë e të dhënave personale të përfshira në të.
Начин на чување на документите	**Mënyra e ruajtjes së dokumenteve**
Член 36	**Neni 36**
(1) Плакарите (орманите), картотеките или другата опрема за чување на документи задолжително треба да бидат сместени во простории заклучени со соодветни заштитни механизми. Просториите треба да бидат заклучени и за периодот кога документите не се обработуваат од овластените лица.	(1) Dollapët, kartotekat ose pajisjet e tjera për ruajtjen e dokumenteve, doemos duhet të vendosen në hapësira të mbyllura me mekanizma të duhura mbrojtëse. Hapësirat gjithashtu duhet të mbyllen edhe për periudhën kur dokumentet nuk përpunohen nga personat e autorizuar.
(2) Кога физичките карактеристики на просториите не дозволуваат примена на мерките од ставот (1) на овој член, контролорот треба да примени други мерки за да се спречи секој неовластен пристап до документите.	(2) Kur karakteristikat fizike të hapësirave nuk lejojnë zbatimin e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, kontrolluesi duhet të zbatojë masa tjera për të parandaluar çdo qasje të paautorizuar në dokumente.
IV. ВИСОКО НИВО	**IV. NIVELI I LARTË**
1. Технички мерки	**1. Masat teknike**
Дополнителни мерки	**Masat shtesë**

Член 37	Neni 37
Контролорот врз основа на анализата на ризикот воведува и применува дополнителни мерки за безбедност на личните податоци со кои ќе демонстрира дополнителна усогласеност со прописите и добрите практики за заштита на личните податоци.	Bazuar në analizën e rrezikut, kontrolluesi prezanton dhe zbaton masa shtesë për sigurinë e të dhënave personale, me të cilat do të demonstrojë përputhshmëri shtesë me dispozitat dhe praktikat e mira për mbrojtjen e të dhënave personale.
Управување со лозинки	**Menaxhimi me fjalëkalimet**
Член 38	**Neni 38**
(1) Контролорот треба да користи алатки за управување со лозинки со кои обезбедува дека различните лозинки за секоја услуга, или софтверска програма соодветно се чуваат, при што за пристап до сите лозинки обезбедува главна лозинка (master password), која треба да биде зајакнато комплексна, односно да биде составена од комбинација на најмалку 12 алфанумерички карактери (букви /мали и големи/), симболи, броеви и специјални интерпукциски знаци) и да се менува во период не подолг од 30 дена.	(1) Kontrolluesi duhet të përdorë mjete për menaxhimin e fjalëkalimeve që sigurojnë se fjalëkalime të ndryshme për secilin shërbim ose program softuerik janë ruajtur në mënyrë përkatëse, ku për qasje në të gjitha fjalëkalimet siguron një fjalëkalim kryesor (master password), që duhet të përforcohet në mënyrë komplekse përkatësisht të përbëhet nga kombinimi i të paktën 12 karaktereve alfanumerike (shkronja/shkronja të vogla dhe të mëdha/), simbole, numra dhe shenja të veçanta pikësimi) dhe të ndryshohet në një periudhë jo më shumë se 30 ditë.
(2) Контролорот во согласност со анализата на ризикот, за одредени овластени лица (на пример за администраторот на информацискиот систем или лицата кои креираат и користат главна лозинка (master password), може да изврши дисперзија на ризикот преку управување со лозинката со дополнителен фактор согласно правилото *n-2*(на пример: информацијата за лозинката да биде поделена на две или повеќе лица кои заеднички ќе се најавуваат на начин што секој ќе знае само дел од информацијата која ја сочинува лозинката, или едно овластено лице ја знае лозинка, а друго ја поседува и употребува паметна картичка – smart card).	(2) Kontrolluesi sipas analizës së rrezikut, për persona të caktuar të autorizuar (për shembull për administratorin e sistemit të informacionit ose personat që krijojnë dhe përdorin fjalëkalimin kryesor (master password), mund të shpërndajë rrezikun duke menaxhuar fjalëkalimin me faktor shtesë sipas rregullit n-2 (për shembull: informacioni për fjalëkalimin të ndahet në dy ose më shumë njerëz që do të regjistrohen së bashku, në atë mënyrë që secili do të dijë vetëm një pjesë të informacionit që e përbën fjalëkalimin, ose një person i autorizuar e di fjalëkalimin, kurse një tjetër e posedon dhe përdor kartë të mençur- smart card).

Сертификација за заштита на личните податоци	**Certifikim për mbrojtjen e të dhënave personale**
Член 39	**Neni 39**
Контролорот, покрај внатрешната контрола од член 27 на овој правилник, а на доброволна основа, може да изврши и проверка на процесите и интерните документи за заштита на личните податоци заради сертификација на процесите преку кои се обработуваат личните податоци, со цел да демонстрира усогласеност со прописите за заштита на личните податоци при операциите на обработка. Сертификацијата се врши од Агенцијата или од сертификациони тела согласно прописите за заштита на личните податоци.	Kontrolluesi, përveç kontrollit të brendshëm nga neni 27 i kësaj Rregullore, në bazë vullnetare, mund të kontrollojë proceset dhe dokumentet e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, për shkak të certifikimit të proceseve, nëpërmjet të cilave përpunohen të dhënat personale, në mënyrë që të demonstrojnë pajtueshmërinë me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale gjatë operacioneve të përpunimit. Certifikimi kryhet nga Agjencia ose nga organet certifikuese në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale.
Управување со преносливи медиуми	**Menaxhimi me mediat portative**
Член 40	**Neni 40**
(1) Контролорот е должен да воспостави систем за евидентирање на медиумите кои се примаат со цел да овозможи директна или индиректна идентификација на видот на медиумот кој е примен, датум и време на примање, испраќач, број на медиуми кои се примени, вид на документ кој е снимен на медиумот, начин на испраќање на медиумот, име и презиме на лицето овластено за прием на медиумот.	(1) Kontrolluesi është i obliguar të krijojë sistem për evidentimin e mediave të pranuara në mënyrë që të mundësojë identifikimin e drejtpërdrejtë ose indirekt të llojit të medias së pranuar, datën dhe kohën e pranimit, dërguesit, numrin e mediave të pranuara, llojin e dokumentit i cili është regjistruar në medium, mënyra e dërgimit të mediumit, emrit dhe mbiemrit të personit të autorizuar për pranim të mediumit.
(2) Одредбите од ставот (1) на овој член се применуваат и за евидентирање на медиумите кои се испраќаат од страна на контролорот.	(2) Dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni zbatohen edhe për evidentimin e mediave të dërguara nga kontrolluesi.
(3) За пренесените медиуми надвор од работните простории на контролорот, треба да бидат преземени неопходни мерки за да се спречи неовластено обработување на личните податоци снимени на нив.	(3) Për mediat e transmetuara jashtë hapësirave të punës së kontrolluesit, duhet të merren masat e nevojshme për ta parandaluar përpunimin e paautorizuar të të dhënave personale të regjistruara në to.
Тестирање на информацискиот систем	**Testimi i sistemit të informacionit**
Член 41	**Neni 41**
(1) Контролорот задолжително врши тестирање на информацискиот систем пред неговото имплементирање или по извршените промени со цел да се провери дали системот обезбедува	(1) Kontrolluesi doemos teston informacionin para zbatimit të tij ose pas ndryshimeve të kryera, që të shihet nëse sistemi siguron sigurinë e të dhënave personale në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e

безбедност на личните податоци согласно со прописите за заштита на личните податоци.	të dhënave personale.
(2) Тестирањето од став (1) на овој член се врши преку обработка на документи кои содржат имагинарни лични податоци.	(2) Testimi nga paragrafi (1) i këtij neni kryhet nëpërmjet përpunimit të dokumenteve që përmbajnë të dhëna personale imagjinare.
Сертификациони постапки	**Procedurat certifikuese**
Член 42	**Neni 42**
Контролорот може да применува и други технички мерки за тајноста и заштита на обработката на личните податоци, преку примена на сертификациони постапки согласно прописите што ја уредуваат употребата на електронски документи, електронска идентификација и доверливи услуги.	Kontrolluesi mund të zbatojë masa të tjera teknike për fshehtësinë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale, duke zbatuar procedurat e certifikimit në dispozitat që rregullojnë përdorimin e dokumenteve elektronike, identifikimin elektronik dhe shërbimet e besueshme.
Пренесување на медиуми	**Transferimi i mediave**
Член 43	**Neni 43**
Медиумите можат да се пренесуваат надвор од работните простории само ако личните податоци се криптирани или ако се заштитени со соодветни методи кои гарантираат дека податоците нема да бидат читливи, при што само администраторот на информацискиот систем може да ги декриптира или лице овластено од него.	Mediat mund të transferohen nga hapësirat e punës vetëm nëse të dhënat personale janë të kriptuara ose të mbrojtura me metoda të përshtatshme që garantojnë se të dhënat nuk do të jenë të lexueshme, ku vetëm administratori i sistemit të informacionit mund t'i deshifrojë ose person i autorizuar nga ai.
Пренесување на личните податоци преку мрежа за електронски комуникации	**Transferimi i të dhënave personale nëpërmjet rrjetit të komunikimeve elektronike**
Член 44	**Neni 44**
Личните податоци можат да се пренесуваат преку мрежата за електронски комуникации само ако се криптирани или ако се посебно заштитени со соодветни методи кои гарантираат дека податоците нема да бидат читливи при преносот.	Të dhënat personale mund të transmetohen vetëm në rrjetin e komunikimeve elektronike nëse ato janë të kriptuara ose nëse janë të mbrojtura me metoda të përshtatshme që garantojnë se të dhënat nuk do të jenë të lexueshme gjatë transmetimit.
2. Организациски мерки	**2. Masat organizative**
Копирање и умножување на документите	**Kopjimi dhe shumimi i dokumenteve**

Член 45	Neni 45
(1) Копирањето или умножувањето на документите може да се врши единствено од страна на овластени лица определени со процедура од страна на контролорот во која задолжително се утврдуваат мерките и начинот на копирањето и умножувањето на документите.	(1) Kopjimi ose shumimi i dokumenteve mund të bëhet vetëm nga persona të autorizuar, të përcaktuar me procedurë nga kontrolluesi ku doemos përcaktohen masat dhe mënyra e kopjimit dhe shumimit të dokumenteve.
(2) Уништувањето на копиите или умножените документи треба да се изврши на начин што ќе оневозможи понатамошно обновување на содржаните лични податоци.	(2) Shkatërrimi i kopjeve ose dokumenteve të shumëzuara duhet të bëhet në atë mënyrë që të parandalojë përsëritjen e mëtejshme të të dhënave personale të përmbajtura.
Пренесување на документи	**Transferimi i dokumenteve**
Член 46	**Neni 46**
Во случај на физички пренос на документите контролорот задолжително презема мерки за нивна заштита од неовластен пристап или ракување со личните податоци содржани во документите кои е пренесуваат.	Në rast të transferimit fizik të dokumenteve, kontrolluesi duhet të marrë masa për mbrojtjen e tyre nga qasja e paautorizuar ose trajtimi i të dhënave personale të përfshira në dokumentet e transferuara.
V. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ	**V. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**
Период на прилагодување	**Periudha e përshtatshmërisë**
Член 47	**Neni 47**
Во смисла на член 119 од Законот за заштита на личните податоци („Службен весник на Република Северна Македонија” бр. 42/20), контролорите и обработувачите се должни да го прилагодат своето работење со одредбите на овој правилник во рамките на периодот предвиден за усогласување со одредбите од Законот за заштита на личните податоци.	Në kuptim të nenit 119 të Ligjit për Mbrojtjen e Të dhënave Personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. (42/20), kontrolluesit dhe përpunuesit obligohen ta përshtatin punën e tyre me dispozitat e kësaj Rregullore brenda periudhës së parashikuar për përshtatje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale.
Престанување на важење	**Ndërprerja e vlefshmërisë**
Член 48	**Neni 48**

Со денот на влегувањето во сила на овој правилник престанува да важи Правилникот за техничките и организациските мерки за обезбедување тајност и заштита на обработката на личните податоци („Службен весник на Република Македонија” бр. 98/03 и 158/10) освен за случаите предвидени во членот 117 од Законот за заштита на личните податоци („Службен весник на Република Северна Македонија” бр. 42/20).	Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, ndërpritet vlefshmëria e Rregullores për masat teknike dhe organizative për sigurimin e fshehtësisë dhe mbrojtjen e përpunimit të të dhënave personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/03 dhe 158/10) përveç rastet e parashikuara në nenin 117 të Ligjit për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42/20).
Влегување во сила	**Hyrja në fuqi**
Член 49	**Neni 49**
Овој правилник влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во „Службен весник на Република Северна Македонија”.	Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.
Бр. ____-_____/____	**Директор,** **Imer Aliu** Nr. ____-_____ / ____
_____._____.2020	_____._____.2020